



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.750/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Mërgim Saqipit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i parashtruar nga Mërgim Saqipit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Mërgim Saqipit kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovë, dega në Kamenicë në të cilin pretendon se ka mos përputhje të raportit mes FRK dhe vëzhguesit për kandidatin me nr. 8 Mergim Saqipi për vendvotimet 1001/05D dhe 1001/04.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Mërgim Saqipit, është i parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga Mërgim Saqipitj dhe si i tillë apeli nuk i plotësonë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshtuar e në mbështetje të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.750/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.